



BULETINI I INSTITUTIT TË SHËNDETIT PÙBLIK

Institute of public health bulletin



2-2010

Alban YLLI
Silva BINO
Eduard KAKARRIQI

Arben LUZATTI
Besa BUDO
Gledjona TOLA

Drejtore
Shefe e Dep. te semundjeve infektive
Shef i Dep. Epidemiologjise se
semundjeve kronike
Shef i Dep. Mjedisit dhe shendetit
Shefe e Dep. te botimeve
Koordinator e buletinit

Realizimi përbotan Genë MUSA

Adresa : Institut i Shëndetit Publik
Rr. Aleksandër Moisiu Nr. 80
Tiranë ALBANIA
Tel / Fax. 00355 43 700 58
Email: iphealth@sans.net

Publikimi i Buletinit të LSH.P.
u sponsorizua nga :
Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë

PERMBAJTJA

Andis KARAGJOZI UDHEZUEZ SHENDETIPER TE MOSHUARIT	4
Dr. Artan SIMAKU SURVEJANCA SINDROMIKE “ALERT”	22
Ass. Prof. Dr. Arben LUZATI; Dr. Valbona BARA; Dr. Oltiana PETRI; Luljeta LENO RAPORT MBI SITUATEN HIGJIENO-SANITARE TE UJIT TE PIJSHEM NE QYTETIN E SHKODRES DHE UJESJELLESAVE RURALE GJATE DHE PAS PERIUDHES SE PERMBYTJEVE	27
Mirela SHIJAKU MONITORIMI I ZHURMAVE URBANE	37

UDHEZUEZ SHENDETI PER TE MOSHUARIT

Andis KARAGJOZI

Shoqeria Shqiptare eshte nje shoqeri ne plakje graduale dhe kjo prirje po theksohet.

Numri i te moshuarve dhe i shumë të moshuarve po rritet drastikisht në mjaft popullsi :

Në ShBA aktualisht 15% e popullsisë janë të moshuar, por kjo parashikohet të arrijë ne 22% te popullsisë në 2030.

Ne Shqiperi ka nje rritje te ndjeshme te numrit dhe perqindjes se te moshuarve

vecanerisht grupit te popullates mbi 80 vjec numri i te cileve do te dyfishohet ne 2021.

Të moshuar konsiderohen njerezit > 60 – 65 vjeç (në shumicën e popullsisë) ; ndersa shumë të moshuar konsiderohen njerëzit > 80 vjeç.

Te moshuarit jane te rrezikuar me teper se te rinte per tu semurur .

Kryesisht te moshuarit duhet te kene kujdes dhe duhet te kene njoburi per disa probleme te rendesishme shendetesore qe shfaqen ne kete moshe dhe duke i njobur keto probleme si dhe marrjen e masave parandaluese do bejne qe ata te gezojne nje shendet me te mire .

Problemët shendetesore tek te moshuarit :

- a. Rrëzimet dhe dëmtimet, që i pasojnë;
- b. Efektet anësore të medikamenteve, ndërveprimi dhe mbidozimi;
- c. Ulja e mprehtësisë së shikimit;
- d. Ulja e aftësisë së dëgjimit;
- e. Humbje progresive e tonusit muskular e pasuar me dobësim të ekstremiteteve;
- f. Osteoporoza me rrezik të lartë të frakturave (figura 6.1);
- g. Inkontinencë urinare;
- h. Anomali nutricionale dhe humbje në peshë;
- i. Anemi;
- j. Hipertension – veçanërisht hipertension sistolik;
- k. Humbje e kujtesës dhe demencë 33progresive;

I. Depresion.

Qëllim parësor i kontrollit mjekësor/ndërhyrjes tek të moshuarit ështe ruajtja e aftësisë funksionale

RREZIMET

Rrezimet tek te moshuarit kane tendencë të ndodhin gjatë aktivitetave të jetes se perditshme.

Rrezimet shkaktojne 29% të demtimeve me pasoje vdekjen ne te moshuarit 65+.

Te moshuarit kane pese here me teper predispozicion per tu shtruar ne spital si pasoje e nje rrezimi sesa e nje demtimi nga shkaqe te tjera.

Tek te moshuarit , rrezimet jane shkaku kryesor i demtimeve me pasoje vdekjen.

Tek te moshuarit , pjesa me e madhe e frakturave shkaktohen nga rrezimet.

Cilet faktore ndikojne ne rritjen e numrit te rrezimeve

Medikamentet : rreziku eshtë më i madh nëse merren më shumë se 4 medikamente në ditë;

- Rënia e mprehtësisë së shikimit, sidomos në dallimin e shkallëve, parregullsive në dyshemë, etj.;
- Ndryshimet në mënyrën e të ecurit dhe mbajtjen e ekilibrit – ulet shtrirja e këmbës në çdo hap;
- Dobësim i ekstremiteteve;
- Marrje mendsh, veçanërisht e shkaktuar nga medikamentet;
- Reziqet rrethanore - qilime/rrugica të pafiksuara, hapa të pabarabartë, korridore dhe shkallë të pandriçuara, mungesa e mbajtëseve dhe mbështetëseve, rrëmuja nga fëmijët;
- Sëmundje kronike – artriti, insulti me paralizë të pjesshme, neuropati periferike veçanërisht e shkaktuar nga diabeti, demenza, sëmundjet e zemrës me aritmë;
- Infeksionet akute (pneumonia, gastroenteriti, diarrea, infeksionet urinare akute).

C'pasoja sjellin rrezimet ?

Frakturat e kockave osteoporotike (të kofshës – 1%/rrëzim; kyçit/kockave të tjera – 5%/rrëzim) (figura 6.3);

- Dëmtim i indeve të buta (hematoma, laceracion – 30-50%/rrëzim);
- Vdekje – veçanërisht si komplikacion i frakturës së kofshës;
- Frika progresive në rritje për të dalë jashtë shtëpisë; aktivitet fizik i ulur.

Me shume se 90 % e frakturave te legenit jane si rezultat i rrezimeve dhe me shpesh ndodhin ne personat mbi 70 vjec. Cdo vit rrezohen 1/3 e banoreve te komunitetit te moshes se trete si dhe 60 % e banoreve neper azilet e pleqve . Si faktore rreziku per rrezimet ne moshen e trete perfshihen : rritja ne moshe, perdonimi i ilaceve , demtime te njohura si dhe mungesa e ndjeshmerise. Vleresimi per nje

pacient te pashtuar ne spital qe eshte rrezuar perfshin historine e mjekimit , nje kontroll mjeksor dhe nje test te thjeshte te kontrollit te gjendjes se per gjithshme te funksioneve. Trajtimi eshte i perqendruar kyesisht ne shkakun e renies dhe mund te kthejne te semurin ne piknisjen e funksioneve.(Am Fam Physian 2000; 61: 2159-68,2173 - 4)

- Si mund te parandalohet nje rrezim

Per te parandaluar nje rrezim duhet te kini parasysh disa rregulla te thjeshta per sigurine ne shtepi, brenda dhe jashte saj.

Llista e kontrollit per sigurine ne shtepi:

Heqjen e objekteve te rena pertoke .

Cepat e tapeteve gjithmone te puthitura me dyshemene.

Te mbahet shtepia ne rregull.

Moslenia e kabllove, zgjatuesve ne mes te dhomes.

Ndricimi i mire gjate nates (kryesisht ne koridorin per tek dhoma e gjumit.)

Fiksoni rrugicat e shkallevet me mbajteset e tyre .

Vendosja e parmakeve ne kafazin e shkallevet.

Eliminimi i karrigeve te cilat jane shume te uleta dhe krijojn veshtiresi ne ngritje apo ulje.

Kujdes ,mos perdorni solucione per lucidimin e parketit laminatit apo pllakave .

Sigurohuni qe telefoni te jete vendosur ne vend lehtesish te arritshem.

Vendosni parmak mbajtes ne dush, dhe anash tualetit.

Vendos tapet gome tek pllaka e dushit.

Mos vendosni tapete tek lavamani .

Instaloni nje ndejtese te larte tek tualeti .

Mjediset ejashtme.

Riparoni rrugicat e demtuara.

Instaloni parmak tek shkallet .

Pastroni kalimet ne kopshtet e shtepise nga shkurret.(krasitini)

Vendosni ndricime ne vendkalimet per gjate oborrit.

PROBLEMET E SHIKIMIT

Ju duhet te dini se 70% e te gjithë pacientëve mbi 65 vjeç kanë shikim të ulur.

Cfare pasojash ka nje i moshuar nga shikimi i dobet.

Humbja e shikimit dëmton funksionin - rrit frikën e rrëzimit, ul aftësinë për të lexuar/ punuar (punë shtëpie), ul aftësinë për të drejtuar makinen,sidomos natën,etj.
Shkaqet më të zakonshme të humbjes së shikimit tek të moshuarit

- Presbiopia (humbja e shikimit nëdistançë të afërt prej ngurtësisë së lenteve të syve) (figura 6.4);
- Katarakti (figura 6.5);
- Degjenerimi i makulës;
- Glaukoma (5% e popullsisë);
- Retinopatia diabetike.

Humbja e shikimit mund të përmirësohet nga trajtimi i problemeve ekzistuese

- Heqja e katraraktit dhe implantim i lenteve;
- Korrektim i syzeve për presbiopi;
- Medikamentet për të ulur humbjen progresive në glaucoma
- Kontroll i rreptë i diabetit;
- Vërejtje – trajtim i vazhdueshëm i degjenerimit të makulës;
- 15-45% e të gjithë të moshuarve kanë humbje të shprehur të dëgjimit.

PROBLEMET E DEGJIMIT

Humbja e dëgjimit ul aftësisë për të kuptuar të tjerët dhe për të komunikuar korrekt dhe mund te pasohet me izolim shoqëror dhe depresion.

Shkaqet më të zakonshme të humbjes së dëgjimit te të moshuarit:

- Presbikusis (humbje progresive e frekuencave të larta – shkaku më i zakonshëm)
- Zhurma në vesh dhe humbja e dëgjimit si pasojë e medikamenteve ototoksiqe (psh, furosemidi, aminoglukozidet, antibiotikët, etj.);
- Humbje e dëgjimit e shkaktuar nga zhurmat, ose dërntime të tjera të mëparshme.

Mjetet për korrigjin e dëgjimit mund të ndihmojnë në përmirësimin e komunikimit shoqëror (figura 6.6).

MEDIKAMENTET TEK TË MOSHUARIT

- Shumë të moshuar marrin minimalisht tre medikamente në ditë dhe shpesh më shumë;
 - Ka rrezik të shprehur për të irregulluar dozat e medikamenteve, pa patur njojuri për to, si dhe të lidhura me ndërveprimin me medikamente ose sëmundje të tjera;
 - Ka efekte serioze anësore për shumë medikamente me doza të përaferta, si pasojë e ndryshimeve të përthithjes, metabolizmit dhe të farmakokinetikës tek të moshuarit.

- Rreziku i ndërveprimit të një medikamenti me 4 ose më shumë medikamente është rreth 90%;
- Humbja e shikimit mund të shkaktojë marrje të barnave të gabuara ose në doza të gabuara;
- Humbja e kujtesës, depresioni, demenza mund të shkaktojë harresë në marrjen e medikamenteve
ose të dozave të tyre.

• Ç'problematika hasen gjate marrjes se medikamenteve ?

Ju duhet te komunikoni me mjekun e familjes dhe duhet t'i tregoni atij(mundesisht t'i merrni me vehte) te gjitha ilacet qe ju perdorni.

Mjeku do tju keshilloje per sasine ,dozat e medikamenteve qe ju merrni.

Duhet te dini se marrja e shume medikamenteve nganjehere mund tju mjekoje per nje semundje dhe mund tju shkaktoje nje efekt anesor , si pershembull marrje mendsh ku ju mund te rrezojeni dhe kjo mund te coje deri ne demtime serioze.(shiko rrezimet)

- Përdorni kombinim medikamentesh kur është e mundur të eleminohen një numër tabletash;
- Përdorni medikamentet, që duhet të merren vetëm një ose dy herë në ditë, nëse është e mundur;
- Përdorni një kuti medikamentesh me ndarje për çdo ditë të javës – pacienti ose të afërmittë të vendosin të gjitha medikamentet në vendin e tyre një herë në javë;
- Ju duhet të hedhni poshtë të gjitha medikamentet që nuk ju duhen apo nuk i përdorni.(mos i mbaj për të ardhmen “se një ditë mund të kem nevojë për to”.)

AKTIVITETI FIZIK DHE TONUSI MUSKULAR

- Aktiviteti fizik eshte mjeti baze per permiresimin e shendetit fizik dhe mendor

Siguron :

- Uljen e tensionin e gjakut;
- Ul rrezikun për sëmundje të arterieve koronare; Përmirëson nivelin e lipideve;
- Përmirëson simptomat dhe funksionin tek pacientët me insuficiencë kardiakë;
- Përmirëson kontrollin e diabetit;
- Ul humbjet kockore, tendencën për fraktura osteoporotike dhe zgjeron lëvizshmërinë e kyçeve
- Përmirëson funksionin në pacientët me osteoartrit;
- Përmirëson simptomat e sëmundjeve arteriale periferike;

- Përmirëson cilësinë e gjumit dhe ndjenjën e të qenit mirë;
- Përmirëson funksionin e njohjes dhe kujtesën afatshkurtër;
- Ul rrezikun e depresionit.
- Përfitimet nga ushtrimet e rregullta janë të mëdha, sidomos në pacientë, që kanë qenë joaktivë.
- Ushtrimet efektive në të moshuarit përqëndrohen në tre drejtime, për të marrë përfitm maksimal :
 - Përmirësim i kapacitetit aerobik (gjendja kardiovaskulare);
 - Përmirësim i forcës së muskujve, sidomos në krahë/këmbë;
 - Përmirësim i ekuilibrit/fleksibilitetit.
 - Shumë autoritete rekomandojnë ekzaminime kontrolli për të moshuarit, të cilët fillojnë programe të ushtrimeve, sidomos për ata me sëmundje kronike ose ata - Personave te moshuar, ose qe kane dale ne pension, ju rekomandohet rreth 30 minuta aktivitet fizik me intensitet te moderuar, si e ecura e shpejte, ne te pakten pese dite te javes. Nderrmarrja e te gjitha mundesive te vogla per te qene aktiv ndihmon ne permiresimin Ecja, bicikleta, riparimet ne shtepi, kopeshtaria, perdonimi i shkallevet, kryerja e puneve me dore

Efektet shendetesore qe shoqerohen me aktivitetin fizik

Inaktiviteti fizik eshte bere nje faktor madhor rrisku per semundjet kronike tek popullatat.

Aktiviteti fizik permireson si mireqenien fizike ashtu dhe ate mendore: pakeson rreth 50% te riskut ne shume crregullime te lidhura me inaktivitetin, te tilla si:

- Semundjet e zemres
- Aksidentet cerebrale
- Mbipesha dhe obesiteti
- Kanceri i kolonit
- Kanceri i gjirit
- Depresioni
- Stresi, ankthi dhe vëtmia
- Hipertensioni

Ne te moshuarit , studimet epidemiologjike kane vertetuar se 15-20% e rrezikut te per gjithhem per semundje koronare te zemres, diabet tip 2, kancer te kolonit, kancer te gjirit, dhe fraktura femorale i atribuohen inaktivitetit fizik.

USHQYERJA DHE HUMBJA NË PESHË

Mungesat ushqimore janë të zakonshme tek të moshuarit. Shpesh, ato mund të çojnë në humbje progresive në peshë, status të dobësuar imunologjik dhe vonesë në shërim.

Kush Jane pasojat shendetesore te ushqyerjes jo te mire.

- Anemi e shkaktuar nga mungesa e hekurit;
- Neuropati periferike, si pasojë e mungesës në folate dhe vitaminë B12;
- Lëkurë ekzematoze e thatë, si pasojë e mungesës së vitaminës B.

Shkaqet

- Të ardhura të ulëta ose të pandryshuara;
- Humbje e shijes ose e nuhatjes – neveritje e ushqimit;
- Efektet anësore të medikamenteve – nauze, dhembje abdominale, oreks i humbur;
- Shëndet i ulët i dhëmbëve; pak dhëmbë të mbetur ose të dhembshëm;
- Vështirësi në blerjen e ushqimeve;
- Paaftësi për të gatuar;
- Depresion ose demencë;
- Ndjenja e përhershme e të qenit i sëmurë ose e sëmundjes kronike;
- Mungesa e kënaqësisë si pasojë e të ngrënët vetëm;
- Përqëndrimi në disa ushqime të pëlqyeshme – dietë e ekuilibruar.

AKTIVITETET PARANDALUESE TEK TË MOSHUARIT

Aktivitetet parandaluese, që sipas të dhënave sjellin përfitime për të moshuarit, janë:

- Imunizimi (nëse është i mundshëm):
- DT imunizimi çdo 10 vjet;
- Vaksina e Pneumokokut – të paktën një injekzion pas moshës 65 vjeç dhe të përsëritet në moshën 65 vjeç nëse është kryer më herët;
- Vaksina e influencës – çdo vit.
- Kalçium dhe shtesa me Vitamin D;
- Aspirinë 60 mg/ditë për të ulur rrezikun e insultit ose të infarktit të miokardit; komplikacione shumë të vogla, që lidhen me hemorragjinë vërehen tek shumë të moshuar (> 80 vjeç);
- Ndërprerje e pirjes së duhanit në çdo moshë;
- Lidhja e rripit të sigurimit në makinë ul rrezikun e aëmtimit në çdo lloj aksidenti;
- Përdorimi i sa më shumë fibrave në dietë;

- Doza ideale - 4-8 g ditë produkte me fibra;
- Përfitimet – pakëson konstipacionin, divertikulozën, çrregullimet rektale; përmirëson nivelin e glukzës në diabetikët; ul simptomat e zorrës së irritueshme.
- Ushtrime ditore të paktën 30 minuta, që të përmirësojnë paaftësitë specifike;

ANEMIA

Cfare eshte anemia. ?

Anemia është një ndër çrregullimet e gjakut, që rezulton nga pakësimi, rënia e numrit të rruazave të kuqe të gjakut në organizmin e njeriut. Ky lloj çrregullimi mund të sjellë probleme të pariparueshme shëndetësore, si rezultat i uljes se nivelit të hemoglobinës në rruazat e kuqe, e cila është një ndër komponentët përbërës më të rëndësishëm të rruazave të kuqe të gjakut, që bën transportimin e oksigenit në të gjitha indet e organizmit. Komplikacionet e shkaktuara janë të shumëllojshme.

Shkaktarët e anemisë janë të shumtë, por ndër më të rëndësishmit mund të veçohen si: Shkatërrimi i tejskajshëm i rruazave të kuqe, humbja e gjakut si pasojë e shumë faktorëve, prodhimi dhe rigjenerimi i pamjaftueshëm i rruazave të kuqe të gjakut, etj.

Por anemia rrjedh edhe nga shkaqe të tjera përveç këtyre që përmendëm më lart, siç janë: Çrregullimet e trashëgura në organizmin e njeriut, kequshqyerja, si mungesa e hekurit dhe vitaminave, infeksionet e ndryshme, prezenca e disa kacereve, ekspozimi ndaj medikamenteve toksike.

Anemia shfaqet në disa mënyra, disa prej të cilave pëershkuhen më poshtë. Disa këshilla të nevojshme për anemikët:

- Lodhje, takikardi, zbehje janë simptomat e anemikëve.
- Anemikët duhet të konsumojnë fruta më vitaminë C.
- Anemikët duhet të konsumojnë spinaq dhe barëra jeshile.
- Anemia zakonisht kurohet me metoda të zakonshme, si ilaçet.

-Fiku, shalqiri dhe luleshtrydhja, efikase për të trajtuar aneminë.
-Anemia shkaktohet si pasojë e një ushqimi të keq.
-Anemikët duhet të pinë 150 gram lëng karotash në ditë.
-Çajin, kakaon dhe kafen duhet t'i marrin tri orë përpëra se të hanë, pasi ndryshtë vështirëson tretjen.
OBSH përcakton si vlera kufi për aneminë $Hb < 12 \text{ gm/dl}$ tek gratë dhe $< 13 \text{ gm/dl}$ tek burrat (figura 6.8). Anemia haset shpesh në të moshuar (10-45% e atyre $> 65 \text{ vjeç}$).

Shkaqet më të zakonshme të anemisë tek të moshuarit janë:

• MUNGESA E HEKURIT:

- Eritrocite të vogla, hipokrome;
- Pamjaftueshmëri e marrjes/përthithjes së hekurit – dietë e varfér, gastrit atrofik, oreksi i ulur;
- Humbje e rritur e hekurit – humbje gastrointestinale e gjakut për shkak të ulçerës, tumoreve gastrike osë të kolonit, përdorimit të analgjezikëve jo-steroidë, divertikulit të kolonit ose angiodisplazisë;

Trajtimi

- bëhet me zëvendësim të hekurit nga goja; vetëm rrallë përdoren injeksionet e hekurit

OSTEOPOROZA

Eshte dobesimi i kockave i cili vjen me kalimin e moshes. Kockat behen poroze duke humbur kalciumin dhe si pasojë fortessine e tyre.

Nuk shfaqin asnjë simptome tek te moshuarit deri ne momentin kur ndodh fraktura.

Prevalanca është më e lartë në gratë se burrat (e barabartë midis të dy sekseve mbi 80 vjeç)

Parandalimi

Masat fillestare, që u rekomandohen të gjithë të moshuarve janë :

- Ushtime fizike të rregullta – ecje ose not çdo ditë;
- Ndërprerje e duhanit;
- Marrje e Ca 1 gm ditë dhe Vitaminë D 600 – 800 UI ditë;
- Nëse është në mjekim për HTA, mendohet përdorimi i një diuretiku (për të ruajtur kalçiumin si dhe tensionin arterial).
- Mund të kryehet kontroll për osteoporozë dhe trajtimi të mbështetet në densitometrinë e kockave, nëse është e mundur;
- Vini re se terapia hormonale për osteoporozë tek të moshuarit tashmë nuk përdoret për shkak të riskut të lartë për hiperkoagulim, kancer të gjirit dhe insult;
- Osteoporoza e rëndë mund të trajtohet duke përdorur bifosfonatet, kalc

HIPERTENSIONI

Cfare është hipertensioni?

Nëse interesoheni të dini se a mund të rregulloni tensionin e gjakut pa marrë ilaçë, përgjigja është tepër optimiste. Sipas specialistëve, në disa raste tensioni i lartë i gjakut, d.m.th. hipertensioni jo shumë i lartë mund të përballohet me sukses duke

realizuar disa ndryshime në jetën e përditshme si dhe në regjimin ushqimor. Të njëjtat udhëzime vleinë edhe për rastet e hipertensionit të mesëm dhe atij shumë të lartë, por gjithmonë në kombinim me terapitë- mjekësore për të pasur rezultat më të mirë.

Simptomat

Hipertensioni zakonisht zhvillohet pa shumë ndërlikime, por në raste të tensionit të lartë paraqet simptoma të tillë sikurse:

- * Dhimbje koke
- * Marramendje
- * Dhimbje dhe ndjenje rëndese në gjoks
- * Pagjumësi
- * Urinim i shpeshtë
- * Etje e madhe
- * Dobësi muskulore dhe humbje ekuilibri.

Rreziqet

*40% e të sëmurëve me tension rrezikojnë të pësojnë hemorragji cerebrale. *16% e tyre rrezikojnë të pësojnë infarkte në zemër. * Sëmundja kërcenon organe të trupit sikurse veshkat etj.

Hipertensioni në shifra

* 25-30% e evropianëve të rritur vuajnë nga hipertensioni. *14% e amerikanëve të rritur vuajnë nga hipertensioni.

* 80% e të sëmurëve me hypertension nuk i nënshtrohen udhëzimeve për përmirësimin e tensionin te tyre, fakt që kushtëzohet nga mungesa e përditshme e ilaçeve, kostoja e lartë e tyre, frika nga reaksione të mundshme të terapisë me ilaçe (rënie e shpejtë e tensionit, kollë etj.) si dhe nga mungesa e komunikimit dhe besimit tek i sëmuri dhe mjeku.

* 95% e rasteve me hypertension nuk i dedikohen ndonjë sëmundje tjetër (p.sh. çrrëgullime nervore, probleme hor¬monale).

Humbisni kilogramët e tepërt

Mungesa e peshës është një hap tepër i rëndësishëm në normalizimin e hipertensionit. Madje nuk është e rastit që shpesh personat që vuajnë nga hipertensioni përfshihen në kategorinë e njerëzve me mbipeshë. Rreziku nga kilogramët e tepërt është më i madh kur mbipesha është grumbulluar në disa pjesë të trupit, konkretisht në bark dhe kraharor. Të mirat e mungesës së mbipeshës janë të shumta. Përveç se ajo ndikon në ujen e ten¬sionit të lartë arterial, vepron edhe në rënien e nivelit të kolesterolit etj. Gjithashtu, ndihmon në rregullim e niveleve të sheqerit në gjak në rast diabeti. Mos harroni se kombinimi i tensionit të lartë, i kolesterolit në rritje dhe

diabetit përbën një faktor tepër rëndues për funksionimin normal të sistemit kardiologjik.

Shëtisni

Specialistët ju këshillojnë të sëmurëve me tension të lartë që të ecin të paktën 2-3 herë në javë për 45 minuta (është kjo koha që nevojitet mesatarisht për të përshkuar një distancë prej 4 kilometresh). Përkundrazi, ata ndalojnë ushtrimet me peshë pasi në këtë mënyrë rritet shumë presioni arterial dhe vonon që të vijë në nivele fiziologjike. Ndërkaq, nuk përjashtohet që një i sëmurë me hipertension të kryejë ushtrime me pesha, por kjo do të realizohet vetëm pasi ai të ketë nisur tashmë një program aerobë; obie, sipas këshillave të mjekut të tij dhe në bazë të rezultateve të analizave të domosdoshme (si psh. test i lodhjes etj.).

Ndërprisni duhanin

Duhanin shkakton çarjen e kapilareve dhe ndikon në humbjen e elasticitetit të tyre. Është provuar se akoma edhe një cigare është e aftë të shkaktojë çarje dhe kjo sepse presioni i gjakut, që qarkullon në brendësi të kapilarëve, rritet. Përveç tensionit të gjakut, shpeshtohen edhe rrahjet e zemrës pasi kjo e fundit është e detyruar të punojë më tepër me qëllim që të mbulojë nevojat e organizmit me oksigen. Me ndërprerjen e duhanit muret e kapilareve bëhen më elastike, ndërsa zemra punon me ritëm normal dhe nuk lodhet.

Kontrolloni stresin

Megjithëse kjo këshillë është e vështirë që të zbatohet, pasi stresi është i pranishëm në jetën tonë të përditshme, e vërteta është se nëse dëshironi ta përballoni me sukses hipertensionin duhet të kontrolloni stresin. Me fjale të tjera, stresi funksionon sikurse duhani, duke çuar në rritjen e tensionit të gjakut. Personat e brezit të tretë janë më të prekur nga hipertensioni pasi kapilarët e tyre janë më të fortë, më shumë pak elasticitet, për shkak të moshës.

Kini kujdes regjimin ushqimor

Rekomandohet : Peshk-zarzavate

* Peshqit (si sardelet, salmoni etj.) përbajnjë tre përbërje yndyrore të cilat është provuar se ndihmojnë në uljen e tensionit të gjakut. Studimet rreth kësaj çështje janë realizuar në popuj të cilët konsumojnë shumë peshk, si p.sh. eskimezët. Natyrisht që efekti i këtyre përbërjeve tek ju varet nga shpeshtësia e konsumimit të peshkut. Mirë është që të preferoni të hani peshk dy herë në javë dhe të kufizoni konsumin e mishit të viqit; derrit, pulës etj. deri në një herë në javë.

* Frutat dhe zarzavatet kanë në përbërjen e tyre lëndë të cilat ndihmojnë në ruajtjen e kapilarëve në gjendje sa më të mirë. Pjesa e brendshme e tyre "sulmohet" nga tensioni i lartë i gjakut, kolesteroli dhe diabeti. Në saje të lëndëve të vlefshme që

përbajnë frutat dhe zazavatet, kapilarët qëndrojnë hapur duke lehtësuar qarkullimin sa më norë mal të gjakut. Specialistët propozojnë që vaktet tuaja të kenë në përbërjen e tyre fruta, zazavate dhe pak yndyrë mishi.

Rregulloni temperaturën e shtëpisë

Iftohti është një faktor rëndues për hipertensionin, megjithëse shumë e injorojnë. Nuk është e rastit që në verë kardiologët zvogëlojnë sasinë e ilaçeve kundër hipertensionit, për shkak se nxehësia ul tensionin. Përkundrazi, ndenja në të ftohtë rrit presionin arterial. Ndaj është e rëndësishme që shtëpia juaj të jetë e ngrohtë tensionit sistolik me afersisht 12 mm çon në :

Cfare perfitimesh kemi nga mbajtja ne parametra optimal te tensionit te gjakut.

- Ulje të insultit me 36%;
- Ulje të sëmundjeve të arteries koronare të zemrës me 25%;
- Ulje të insuficiencës kardiake me 54%;
- Ulje të vdekshmërisë me 13%.
- Diuretikët dhe/ose betabllokuesit përdoren zakonisht tek të moshuarit dhe jepin rezultate të mira;

Përdorimi i antihipertensivëve të tjera (Ca + bllokues, ACE inhibitorë) mund të ketë efekt pozitiv të së njejtës shkallë.

SËMUNDJA ARTERIALE KORONARE

Ç'ështe semundja koronare te zemres ?

Nje nga semundjet me te shpeshta te zemres eshte semundja koronare e zemres. Ajo zakonisht shkaktohet nga ateroskleroza, qe eshte një grumbullim i substancave yndyrore brenda mureve te arterieve te zemres.

Ç'ështe semundja koronare e zemres ?

Ne kete semundje arteriet qe ushqejne zemren me oksigen dhe lende ushqyese behen me te ngushta prej aterosklerozes. Kjo kufizon furnizimin me gjak dhe oksigen te zemres, sidomos ne sforcim, kuar asaj i duhet te punoje me shume.

Cilat jane simptomat e semundjes koronare te zemres ?

Shenja kryesore eshte angina e shkaktuar nga reduktimi i sasisë se oksigjenit qe arrin ne muskul, per shkak te pakesimit te fluksit te gjakut. Angina eshte një ndjenje rendese, pickimi, apo dhimbje ne mesin e kraharorit qe mund te perhapet ose te preke edhe krahan e majte, qafen, mjekren, ftyren, shpinen ose barkun.

Ne shumicen e rasteve perjetohet ne sforcim. Nese ju vraponi per te kapur autobusin, ngjisni shkallet, ne te ftohë apo pas nje ngrenie te rende, si edhe kur ndjeheni i stresuar. Mund te ndaloje nese ju ndalon si sforcimin ose merni mjekim.

Këshillat

Mos pini duhan
 Mbani një dietë të shëndetshme
 Mbani në kontroll peshën trupore
 Mbani në kontroll nivelin e kolesterinës
 Bëni të paktën 30 minuta ushtrime fizike në ditë

Elementi kryesor i trajtimit të sëmundjes arteriale koronarete të moshuarit është kontrolli i faktorëve të rizikut: ndërprerja e duhanit; Aspirina ($\frac{1}{2}$ tablete/ditë) është ende efektive në uljen e rizikut të insultit/infarktit të miokardit, megjithëse rreziku i komplikacioneve hemorragjike është lehtësisht i rritur tek të moshuarit. Trajtimi i simptomave anginoze është përgjithësisht simptomatik, duke përdorur nitroglycerinë ose nitrate me efekt të gjatë, Ca bllokues, beta bllokues. Insuficienca kardiake shoqëruese tashmë mund të kontrollohet me ACE inhibitorët ose beta bllokuesit dhe diuretikët.

INKONTINENCA URINARE

Cfare eshte inkontinenca urinare ?

Ndodh në 15-30% të të moshuarve dhe 20-55% të grave të moshuara. Në të sëmurë > 70 vjeç të shtruar nëpër spitale, ky çrregullim ndeshet në 45% të rasteve. Ky çrregullim mund të çojë në izolim të shprehur shoqëror dhe në ulje të ndërveprimt.

Inkontinenca nga streset.

Inkontinenca nga tejmbushja evezikës. Ndodh kur rrjedhja e urinës bëhet nga vezika urinare e tendosur, e mbushur shumë si pasojë e obstruksionit nga hipertrofia e prostatës, stenoza e uretrës, atonia e vezikës, etj.

KANCERI I PROSTATËS

Simptomat janë vështirësi gjatë urinimit; nevojë për të urinuar shpesh; mbajtje me vështirësi e urinës; infeksione të rrugëve urinare dhe gjak në urinë.

Trajtimi.

Trajtimi përfshin trajtimin kirurgjikal;medikamentoz specifik; medikamentoz simptomatik.

Cfare duhet te beni per te parandaluar semundien e prostates?

Mënyra e të ushqyerit ka një rëndësi të veçantë në kurimin e duhur të kësaj sëmundjeje. Kështu është e nevojshme që patientët të cilët vuajnë nga prostatata të bëjnë kujdes më mënyrën e të ushqyerit e sidomos me produkte të cilat mund të acarojnë më shumë gjendjen. Sipas doktorit është e nevojshme që ti vihet fre përdorimit të lëngjeve me gaz. Nëse patientët e sëmurë do të konsumojnë nga këto lëngje sidomos gjatë orarit të darkës do ta kenë shumë të vështirë që të bëjnë një gjumë të rehatshëm,

ndërkohë që këta pacientë gjatë natës ngrihen disa here pasi kanë shqetësim të vazhdueshme. Kjo përfaktin se organizmi ngacmohet dhe nuk kryen funksionin tij siç duhet. Njëkohësisht është e ndaluar dhe përdorimi i kafesë. Këta pacientë nuk duhet të konsumojnë fare kafen, sepse përbajtja e lartë e kafeinës çon në krijimin e problemeve me hormonin e testosteronit. Ndërkohë që dhe përdorimi i alkooli është parë si një ndër rënduesit e kësaj, sëmundjeje. Kjo mbetet pak problematike sepse shumë nga moshat e vjetra konsumojnë në masë alkool dhe e rëndojnë më shumë gjendjen e tyre. Përdorimi i alkoolit mund të çojë në rëndimin e organizmit dhe të shfaqe shenja lodhjeje të pacientit edhe pse në fillim mund të ndodhë që nuk i jep të gjitha shenjat. Ndërsa kombinimi i alkoolit dhe me duhanin çon më tepër në irritimin e organizmit dhe blokimin e punës së tij. Sipas doktorit pacientët duhet të kenë kujdes në përdorimin e ushqimeve të cilat duhet të janë të rekomanduara nga mjeku si dhe të shmangen produktet e yndyrta, të cilat mund te janë të vështira për tu shpërbërë.

Lëvizja

1 orë ecje në ditë bën mirë për sëmundjen

Një tjetër kurë e rëndësishme për shmangjen e pasojave që mund të lërë prostata është lëvizja gjatë ditës. Kështu është e rekomanduar që të paktën 1 orë në ditë pacientët që vuajnë nga prostata duhet të bëjnë ecje, kjo sipas doktorit çon në shtendosjen e organizmit. Por dhe ecja duhet bërë me kufi.

Mjekimi bëhet sipas faktorit etiologjik, përfshirë këtu faktorët stresantë, infeksionet, ilaçet etj. Kujdes duhet bërë në përdorimin e kateterit, i cili rrít infeksionet si dhe për higjienën dhe anën psikologjike të të sémurit të moshuar.

POSTMENOPAUZA

Menopauza është pika e ndalimit të aktivitetit menstrual. Perimenopauzë quhet periudha e pakësimit/paqëndrueshmërisë së fluksit estrogenik, që paraprin menopauzën. Postmenopauza është periudha kohore nga ndalimi i aktivitetit menstrual e deri në fund të jetës.

Menopauza pason ndalimin e prodhimit të estrogeneve dhe progresteronit. Mosprodhimi i tyre në menopauzë shkakton ndalimin e menstruacioneve, humbjen e aftësisë pjellore tek gruaja, si dhe shqetësimet e tjera në këtë periudhë. Ndryshimi i nivelit të estrogenit/progesteronit fillon që në premenopauzë, ku niveli i estrogenit rritet dhe i progresteronit ulet. Gratë, që ekspozohen ndaj stresit, hyjnë në menopauzë më herët. Shkak për menopauzën e hershme është edhe duhanpirja. Efekte afatgjatë

të deficítit estrogenik janë: osteoporozë; rritja e rizikut për sëmundjen Alzheimer; rritja e incidencës së SKV. Ndërpërja e menseve është e vëmja shenjë, që kanë të gjitha gratë.

ÇRREGULLIME NEUROLOGJIKE TEK TË MOSHATARIT

Ankthi dhe depresioni tek i moshuari.

Tek të moshatarit, mund të shfaqen më shpesh ankthi dhe depresioni sidomos nëse gjatë jetës kanë qenë të predispozuar. Jo të gjitha format e ankthit dhe depresionit janë reaktive. *I moshuari mund të ketë frikë të pamotivuar dhe jo në përputhje me realitetin.* Ai mund të jetë indiferent ose i trishtuar dhe nuk preokupohet si më përpara, qan shpesh, Kujtesa mund të kufizhet dhe shfaqen çrregullime të ndryshme, edhe fizike. Asnjëherë nuk duhennëvlerëuar këto çrregullime. Një person me depresion nuk është kurrë i parikuperueshëm, por ka nevojë për ndihmë të përshtatshme. Barnat e dhëna nga mjeku në të moshatarit, kanë aq vlerë sa edhe prania afektive rrëth tij.

Demenca

Me demencë kuptohet humbja e pakthyeshme e kapacitetit intelektual të fituar më parë, e shkaktuar nga një dëmtim cerebral dhe që ndikon në aktivitetin social/profesional. Kësaj i bashkohet gjithnjë një çrregullim i kujtesës.

Sëmundja Alzheimer.

Çfarë është sëmundja e Alzheimer?

Alzheimer është një sëmundje që prek trurin, (neurodegenerative) mosfunkcionim normal i disa qelizave nervore, që shkakton në mënyrë progresive të pariparueshme humbjen e memorjes, duke shkaktuar kështu edhe vështirësi në gjestet e jetës së përditshme.

Shkaqet e sëmundjes

Origjina e kësaj sëmundjeje është akoma e paspjegueshme, e mjekët nuk e dinë akoma si të ndalojnë progresin e kësaj sëmundjeje. Kërkuesit dinë, që kjo sëmundje prek moshat pas 65 vjeç, por ka raste që kjo prek edhe mosha më të reja se 50 vjeç, dinë që kjo sëmundje prek po aq meshkuj sa dhe femra. Dinë gjithashtu, që nuk është sëmundje ngjitime, nuk ka lidhje me problemet arteriale cerebrale e nuk vjen nga stresi. Por kërkuesit nuk shpjegojnë asnje shkak të kësaj sëmundjeje.

Sëmundja Parkinson.

Shenja e dukshme e sëmundjes Parkinson janë dridhjet, sidomos në gjymtyrë; me përparimin e sëmundjes, simptomat shtohen. Vështirësitet, gjatë sëmundjes janë dridhjet, bllokimi imuskujve, ngadalësimi i lëvizjeve, vështirësitet për balance në ecje, humbja e kujtesës për rrëth 20% të pacientëve. Sëmundja fillon kryesisht në moshën 60-65 vjeç; barnat duket se bëjnë efekt në vitet epara të prekjes, por më pas efektet dobjësohen.

Simptomat: Dridhje duarsh (edhe në qetësi); Muskujt e dorës/krahut ngurtësohen; vështirësi në ecje; mosmbajtje ekuilibri (në fazë të rënduara të sëmundjes pacientë rrëzohen shpesh).

Çrregullimet e gjumit. Çrregullimet e gjumit përfshijnë disomnitë dhe parasomnitë.

Në disomnitë, siç janë insomnia (pagjumësia) dhe hipersomnia, simptoma kryesore është çrregullimi i sasisë/cilësisë së gjumit. Ky është çrregullim, që në pjesën më të madhe të rasteve prekin te rriturit,

dhe veçanërisht të moshuarit .

Trajtimi

Përfshin masa të përgjithshme (rregullim i rregjimit te gjumit, aktivitet fizik i përditshëm,mosqëndrim i zgjatur në shtrat, shmangje e kafeinës dhe alkoolit) dhe përdorim i barnave (kur kanë dështuar masat e përgjithshme) 2-5 ditë për çdo cikël; mund të merret Melatonina (200 – 400 mg/natë), Antihistaminë (Difenhidraminë ose prometazinë – 25-50 mg/natë), antidepresantë (imipraminë ose amitriptilinë – 25-50 mg/natë), hipnotikë të tjera (lorezapam 1-2 mg/natë).

DEMENCA

Çfarë është demenca?

